



## Arsyetim

Me dt.19.04.2022, Prokurori Disiplinor i OAK-së, në Komisionin Disiplinor, ka paraqitur Propozimin Disiplinor nr. 07-4/2021, kundër të paraqiturit, av. me propozimin që të zhvillohet procedura disiplinore kundër tij dhe t'i shqiptohet masa disiplinore për shkelje nga neni 118, pika 1.15 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës, lidhur me nenin 36, pika a) e Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit. Procedura disiplinore kundër të paraqiturit është inicuar sipas detyrës zyrtare nga Prokurori Disiplinor, pasi vet i paraqituri e kishte njoftuar zyrën për angazhim ex officio të OAK-së, për shkeljen disiplinore. Në propozimin disiplinor, prokurori pretendon se, i paraqituri me dt. 08.02.2021, ka prezantuar në Prokurorinë Themelore Prishtinë (PTHP), me çka ka shkelur Vendimin, nr. 284/21, të dt. 03.02.2021, të Këshillit Drejtues të OAK-së, me të cilin vendim, Këshilli kishte vendosur që të bojktohet Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe bojkoti të fillonte nga dt. 08.02.2022.

Me dt. 16.05.2022, Kolegji Disiplinor, mbajti seancën e shqyrtimit paraprak dhe pasi shqyrtoi propozimin e Prokurorit Disiplinor nr.07-4/2021, dt. 19.04.2022, mori vendim që të zhvillohet procedura disiplinore ndaj të paraqiturit.

Me dt. 02.06.2022, Kolegji Disiplinor mbajti seancën e shqyrtimit kryesor disiplinor, në prezencën e Prokurorit Disiplinor, z. Rexhep Veseli, dhe të paraqiturit.

Komisioni Disiplinor i OAK-së, konform dispozitave të nenit 25, 28, 29, 30, 34 dhe 35 të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë të OAK-së, pasi konstatoj se janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës kryesore dhe pasi nuk kishte vërejtje në përbërjen e kolegjit disiplinor dhe procesmbajtëses, si dhe konstatimit se i paraqituri ka pranuar me kohë propozimin disiplinor dhe të gjitha provat e bashkangjitura, hapi seancën kryesore të shqyrtimit disiplinor me njoftimin e çështjes disiplinore sipas Propozimit Disiplinor. Propozimin Disiplinor e lexoi Prokurori Disiplinor dhe mbeti edhe më tej pranë tij.

I paraqituri deklaroi se nuk e pranon përgjegjësinë disiplinore, dhe mbeti në tërësi pranë përgjigjes me shkrim.

Kolegji Disiplinor, administori provat si në vijim: Fletëparaqitja (njoftimi), me nr. 07/21, dt. 09.02.2021, Emaili i dt. 11.02.2021 që përmban, kërkesën për sigurim inofrmacioni të Prokurorit Disiplinor dhe përgjigjes së zyrtarit për Komunikim, provën nga interneti që njoftimi me vendimin 284/21, ka shkuar në adresën elektronike të të paraqiturit; artikullin nga portali "Epoka e Re", dt. 04.02.2021; artikulli i portalit "Sinjali", dt. 03.02.2021; artikulli i portalit "Koha ditore", i dt. 03.02.2021; Vendimi i Këshillit Drejtues të OAK-së me nr. 284/2021, dt. 03.02.2021; përgjigja e të paraqiturit, dt. 24.02.2021. Kolegji Disiplinor, ex officio nxori dhe administroi si provë edhe njoftimin e dërguar nga OAK për bojkotimin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dt. 04.02.2021, si dhe

listën e pranimit të emailit nga i paraqituri nga sistemi mailchimp.com. Lidhur me provat e administruara nuk pati vërejtje.

I paraqituri në mbrojtjen e tij deklaroi se, “është fakt që unë kam deklaruar këtë çështje vet, personalisht kam njoftuar Odën lidhur me këtë çështje ku jam njoftuar nga motra e të dyshuarit se ekziston ky vendim për mos me shku në Prokurori, këtë më duket e kam cekur edhe me orë se kur më ka ftuar motra e të dyshuarit pastaj, e ka njoftuar Odën se unë kam qenë, unë nuk kam ditë. Është fakt që Oda e ka dërguar njoftimin në adresën time, mirëpo është dërguar në një program spam i cili është i fshehur dhe nuk del menjëherë bile është karakteristikë që unë nuk di as ku gjindet, ka ardhur djali e ka hapur dhe unë e kam kuptuar, bile është karakteristikë se të gjitha njoftimet e Odës tani po më vijnë në spam dhe ai nuk tregon që ka email pa e hapur vet. Unë nuk kam pasur njohuri dhe nuk e kam bërë me vetëdije dhe pastaj e kam kuptuar. Prokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë më ka thirrë edhe më ka thënë se në zyrën time kam një të pandehur i cili të kërkon ty si avoakt. Unë kam shkuar në Prokurori ku i pandehuri të cilin e kam njohur ma ka bërë autorizimin drejtpërdrejtë në procesverbal dhe kam vazhduar me marrjen në pyetje. Prokurori nuk më ka treguar që ka një bojkot nga OAK, dhe për këtë fakt më vonë kam shkuar dhe i kam hyrë në zyre Prokurorit dhe ju kam drejtuar duke i thënë më ke futur në telashe me OAK-në pasi i tregova që ndaj meje për këtë çështje po hapet procedurë disiplinore. Sa i përket shtypit ditor kurrë në jetë nuk i hapi as nuk i lexoj”.

Në fjalën përfundimtare Prokurori Disiplinor, deklaroi se: shkelja e normuar me nenin 118 pika 1.15 e Statutit të OAK-së dhe me nenin 36 pika a) e KEPA-së konsiderohet si shkelje veçanërisht e rëndë. Komisionit Disiplinor i propozoi që si rrethanë lehtësuese të merret vet lajmërimi i shkeljes nga avokati dhe pas vlerësimit të këtyre rrethanave i njëjti të ndëshkohet konform normativave të OAK-së.

I paraqituri, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: mbetem në tërësi si në theksimet shkresore dhe gojore të seancës së sotem nga provat e administruara, veçanërisht lista e aktivitetit të emailit të OAK-së me dt. 11.02.2021 në ora 17:52, gjithashtu u vërtetua se në formë fizike ky dokument përmes zyrës së ZPD-së ka mbërri në zyrën time ashtu siç e kam shpjeguar në përgjigje, çka vërtetohet se unë nuk kam pasur njohuri për ekzistimin e një vendimi të tillë. Një fakt që Komisioni duhet ta merr dhe duhet të vërtetoj që unë nuk kam pasur është fakti që unë personalisht kam denoncuar vetën time në zyret e OAK-së, prandaj unë konsideroj që pavarësisht ekzistimit të normativave të OAK-së për masa disiplinore në rastin konkret nuk e ndiej vetën përgjegjës sepse nuk kam ditur ekzistimin e një vendimi të tillë të OAK-së. Po të kisha pasur njohuri unë nuk do të merrja pjesë në atë seancë.

Në bazë të provave të lartcekura, të administruara në shqyrtimin disiplinor, Komisioni Disiplinor, vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni lexoi vendimin nr. 284/21, dt. 03.02.2021, të Këshillit Drejtues të OAK-së. Me këtë Vendim, Këshilli Drejtues i OAK-së, ka vendosur që nga data 08.02.2022, të bojkotohet Prokuroria Themelore në Prishtinë, nga të gjithë avokatët e Republikës së Kosovës, për shkak të trajtimit të padinjitetshëm të avokatëve, lidhur me çasjen e tyre

në objektin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe u kishte përkujtuar avokatëve se mosrespektimi i vendimit përbën shkelje të rëndë disiplinore. Kolegji lexoi dhe analizoi edhe arsyetimin e vendimit, dhe vërtetoi se ky vendim ishte marrë për shkak të ankesave të shumta të avokatëve se, ata po trajtoheshin në mënyrë jo korrekte dhe të padinjitetshme gjatë hyrjes në objektin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, duke u detyruar t'iu nënshtrohen kontrolleve të shumta e të panevojshme, duke u detyruar avokatët që sa herë hyjnë në objektin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, qoftë edhe disa herë brenda ditës, të kalojnë e detektohen në skanerin e dëmshëm të vendosur në hyrje të objektit; duke u detyruar avokatët po ashtu, t'ua dorëzojnë telefonat e tyre personal zyrtarit të sigurimit të Prokurorisë Themelore me rastin e hyrjes në objekt. Ky vendim ishte marrë me datën 03.02.2022, pas dështimit të disa kërkesave me shkrim të OAK-së drejtuar PTHP, që pengesat të hiqeshin, dhe zbatimi i tij ishte caktuar të fillonte nga dt. 08.02.2022, ora 08:00, duke i lënë kohë Prokurorisë Themelore që deri në këtë datë t'i hiqte këto pengesa për avokatët.

Nga njoftimi i dt. 04.02.2022, i OAK-së të administruar si provë në shqyrtimin disiplinor, vërtetohet se njoftimi për bojkotim së bashku me vendimin 284/21, dt. 03.02.2021, u është dërguar të gjithë avokatëve me dt. 04.02.2022 në adresat e tyre elektronike.

Nga përgjigja e zyrtarit për komunikim rreth dërgimit të njoftimit për bojkotim dhe vendimit 284/21, nga prova e internetit prej sistemit mailchimp, vërtetohet se të paraqiturit i është dërguar njoftimi së bashku me vendim me dt. 04.02.2022. Nga lista e pranimit të emailit nga i paraqituri nga sistemi mailchimp.com vërtetohet se emaili-njoftimi është hapur nga i paraqituri me dt. 11.02.2022.

Nga artikujt, e portaleve, artikulli i Epoka e Re, dt. 04.02.2021, me titull "Oda e Avokatëve bojkoton Prokurorinë Themelore në Prishtinë; artikulli i portalit Sinjali, dt. 03.02.2021, me titull: Oda e Avokatëve bojkoton bashkëpunimin me Prokurorinë Themelore në Prishtinë, vendimi pritet të hyjë në fuqi së shpejti"; artikulli i portalit "Koha ditore", i dt. 03.02.2021, me titull "Oda e Avokatëve vendos të bojkotohet Prokuroria Themelore në Prishtinë, kolegji vërtetoi se opinioni kosovar ka qenë i njoftuar se Oda e Avokatëve ka vendosur të bojkotoj PTHP, për shkaqet e cekura në vendimin 284/21.

Kolegji lexoi edhe përgjigjen e të paraqiturit në fletëparaqitje, dt. 24.02.2021. Nga kjo përgjigje dhe nga deklarata mbrojtëse të paraqiturit vërtetohet se ai me dt. 08.02.2022, ka marrë pjesë në seancën e marrjes në pyetje në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. I paraqituri në përgjigje dhe në deklaratën e tij deklaroi se unë nuk kam pasur njohuri se ka filluar bojkoti ndaj Prokurorisë, nuk kam qenë i informuar, prandaj konsideroj se përgjegjësia ime nuk ekziston. Por, Kolegji Disiplinor në bazë të provave të administruara dhe deklaratës së vet të paraqiturit vërtetoi se ekzistonte përgjegjësia disiplinore e të paraqiturit. Për Kolegjin fakt vendimtar për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore është se i njëjti gjatë periudhës së bojkotit të PTHP nga OAK, ka marrë pjesë

në seancën e marrjes në pyetje në PTHP, këtë fakt Kolegji e vërtetoi përmes deklaratës së të paraqiturit në përgjigjen e tij në fletparaqitje dt. 24.02.2021 dhe deklaratës së të paraqiturit në shqyrtimin disiplinor 02.06.2022. Për Kolegjin nuk ishte fakt relevant nëse i paraqituri ka qenë në dijëni ose jo të vendimit të OAK-së për bojkotim. Në të vërtetë, këtë fakt, (nëse ai ishte apo s'ishte në dijëni të vendimi) Kolegji gjatë shqyrtimit disiplinor nuk mundi ta vërtetojë. Deklarata e të paraqiturit se nuk ka qenë në dijëni për vendimin, për Kolegjin ishte e pabesueshme, për shkak të shpërputhjeve në deklaratat e tij, por edhe sikur të ishte e besueshme, kjo nuk ishte fakt i cili e lironte nga përgjegjësia disiplinore të paraqiturin, sepse të paraqiturit njoftimi dhe vendimi për bojkotimin e PTHP, i ishte dërguar në adresën elektronike katër ditë më herët dhe ai mund të ishte në dijëni të vendimit ashtu si edhe avokatët tjerë, përveç kësaj, burim i informacionit për bojkotin ndaj PTHP, nuk ishte vetëm njoftimi përmes emailit, por edhe mjetet e informimit publik, andaj Kolegji nuk gjeti shkaqe të arsyeshme për shkak të të cilave i paraqituri ka mundur të mos jetë në dijëni të vendimit nr. 284/21 të dt. 03.02.2021. Kishte shpërputhje në deklaratën e të paraqiturit të dhënë në përgjigjen me shkrim të dt. 24.02.2021 dhe deklaratës së tij në shqyrtimin disiplinor 02.06.2022. Ai në përgjigjen e dhënë me dt. 24.02.2021, pohon se, "njoftimi për bojkotimin nuk ka ardhur në emailin tim, këtë mund ta vërtetoni edhe nëse bëni egzaminimin e kompjuterit tim që do t'ua jap ne dispozicion", ndërkaq në deklaratën e dhënë në shqyrtimin disiplinor deklaroi se, pas një ose dy ditëve nga dita e marrjes pjesë në seancë, (që i bie me dt. 10.02.2021) ka ardhur djali im në zyre dhe ma ka hapur emailin dhe unë e kam kuptuar.

Bazuar në provat e cekura lartë e të administruara në shqyrtimin disiplinor, Kolegji në mënyrë të padyshimt vërtetoi se i paraqituri, me pjesëmarrjen e tij në seancë në PTHP, me dt. 08.02.2021, nuk e ka respektuar/zbatuar vendimin nr. 284/21, 03.02.2021 të Këshillit Drejtues të OAK-së, me çka ka kryer shkelje të rëndë disiplinore nga neni 118, pika 1.15 të Statutit të OAK-së, lidhur me nenin 36, pika a) e Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit. Statuti i Odës së Avokatëve në nenin 118, pika 1.15 përcakton si shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë, mospërmbushjen e vendimeve të Odës. Kodi i Etikës Profesionale të Avokatit moszbatimin e vendimeve të Odës e përcakton si shkelje veçanërisht të rëndë të detyrës së avokatit. Bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar si më lartë dhe në dispozitat e lartcekura të Statutit të OAK-së, përkatësisht të Kodit Etikës Profesionale të Avokatit, Kolegji erdhi në përfundim se shkelja disiplinore kishte ndodhur dhe se ndaj të paraqiturit duhej shqiptuar masë disiplinore si në dispozitivin lartë. Moszbatimi i vendimeve të Odës, është e përcaktuar si shkelje veçanërisht e rëndë, megjithatë, Kolegji Disiplinor pati parasysh sjelljen e të paraqiturit pas kryerjes së shkeljes, i cili vet e kishte lajmëruar Odën për shkelje dhe këtë e mori si rrethanë veçanërisht lehtësuese, pastaj rrethanë lehtësuese e mori edhe faktin se sipas evidencave të Odës i paraqituri nuk ishte recidivist. Edhe Prokurori Disiplinor, në fjalën e tij përfundimtare i propozoi Kolegjit që vetlajmërmi i të paraqiturit të merret si rrethanë lehtësuese. Kolegji vendosi për këtë lloj dhe lartësi të masës, me bindjen se është masë adekuate dhe e mjaftueshme për arritjen e qëllimit të masës disiplinore.

Vendimi për masën u mor bazuar në nenin bazuar në nenin 51, paragrafi 1, nënparag, 1.1 të Ligjit për Avokatinë nr. 04/L-193.

Lidhur me shpenzimet e procedurës dhe paushallin disiplinor, Kolegji vendosi që i paraqituri të ngarkohet vetëm me paushallin disiplinor, sepse shpenzime për ekspert, dëshmitarë dhe përkthyes nuk kishte, andaj këtë vendim e mori në bazë të nenit 37, paragrafi 1, të Rregullores për Procedurën Disiplinore për Avokatë dhe Praktikantë.

Bazuar në arsyet e cekura lartë, Komisioni Disiplinor, vendosi ashtu si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Komisioni Disiplinor i Odës së Avokatëve të Kosovës**  
V.KD.Nr.9-3/22, dt. 02.06.2022

Procesmbajtësja  
Ma.sc. Vjollca Ajeti

Kryetar i Kolegjit Disiplinor  
Av. Rrahim Ajeti

**KËSHILLË JURIDIKE**

Kundër këtij vendimi, palët kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Komisionin e Ankesave të OAK-së, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimi të vendimit. Ankesa i dërgohet Komisionit të Ankesave në OAK, përmes këtij Komisioni.